AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Procesverbalet e mbledhjeve të datës 29 Maj 2023 dhe asaj të jashtëzakonshme datë 15 Qershor 2023 nëpërmjet kësaj aprovohen si procesverbale të mbledhjes së Bordit të cekura më lartë.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi sipas procedurave procesverbalet e mbledhjeve paraprake të mbajtur me datë 29 Qershor 2023 dhe asaj të jashtëzakonshme me datë 15 Qershor 2023. Dokumentet aprovohen në pajtim me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenin 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së.

Duke marrë parasysh këtë, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA
Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska Agencija za Privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo
ZQ / KQ / QS - Prishtinë - Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 2367 m2, pjesë e parcelës Kadastrale Nr. 4715/9, me sipërfaqe te përgjithshme 2367 m2, ZK Pejë, Komuna Pejë pronë e NSH "Ina Trgovina" Zagreb, me parashtruesin**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilit rekomandohet refuzimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 2367 m2, pjesë e parcelës Kadastrale Nr. 4715/9, me sipërfaqe te përgjithshme 2367 m2, ZK Pejë, Komuna Pejë pronë e NSH "Ina Trgovina" Zagreb, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë si dhe faktin qe rasti nuk i përmbush kriteret për blerjen e asetit ne pronësi shoqërore përmes procedurës se negocimit direkt sipas Rregullores Nr. 06/2022 Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 985 m2 dhe për sipërfaqen tokësore 3111 m2, pjesë e ngastra kadastrale Nr. 990/1, me sipërfaqe e përgjithshme 4096 m2, ZK Lubizhdë, Komuna Prizren, me parashtruesit dhe**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi Raportin Rekomandues të Njësisë për Negocim Direkt, në të cilit rekomandohet refuzimi i inicimit te procedurës për shitje me negocim direkt, për sipërfaqen tokësore 985 m2 dhe për sipërfaqen tokësore 3111 m2, pjesë e ngastra kadastrale Nr. 990/1, me sipërfaqe e përgjithshme 4096 m2, ZK Lubizhdë, Komuna Prizren, me parashtruesit dhe

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë si dhe faktin qe rasti nuk i përmbush kriteret për blerjen e asetit ne pronësi shoqërore përmes procedurës se negocimit direkt sipas Rregullores Nr. 06/2022 Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-183/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 18, 19 dhe 28 të Shtojcës së po të njëjtit ligj, Nenit 3.10.1 të Rregullores për Procedurat e Likuidimit miratuar nga BD me 22 dhjetor 2020, Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (amadamentuar me 17 maj 2023 përmes Rregullores 02/20230, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet lirimi nga pagesa e qirave për periudhën 15.03.2022 deri me 28.02.2023 në vlerë të përgjithshme prej 51,318.05 € për kërkesën e qiramarrësit "IP KOS" shpk për deponinë e derivateve të naftës në Bardhosh në pronësi të NSH OTHPB DN "INA" Prishtinë (PRN149).**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit lidhur me kërkesën e "IP KOS" shpk për shlyerjen e borxhit dhe rimbursimin e mjeteve të paguara në emër të qirasë për deponinë e derivateve të naftës në Bardhosh – NSH OTHPB DN "INA" Prishtinë (PRN149)– Deponia në Bardhosh, Prishtinë.

NSH "INA Trgovina Zagreb" PRN149 është në proces të likuidimit që nga data 18.01.2021. Duke qenë se AKP-ja mes tjerash ka për synim ruajtjen dhe rritjen e vlerës së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore me qëllim të gjenerimit të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë, Depo e Derivateve të Naftës në Bardhosh ishte tenderuar për qiradhënie. Pas procesit të tenderimit për qiradhënie mbajtur me datë 31.01.2022, Kompania IP-KOS shpk kishte pranuar të hyjë në marrëdhënie kontraktuale për vlerën e ofertës fituese prej 11,111.00€ qira mujore. Kontrata e qirasë në mes të AL për NSH INA dhe IP-KOS ishte nënshkruar me datë 15.03.2022 me kohëzgjatje 2 (dy) vjecare, pra deri me 14.03.2024.

Pas nënshkrimit të kontratës së lartcekur, qiramarrësi ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me pamundësinë e operimit e njëkohësisht edhe të shfrytëzimit të asetit sepse nuk kishte mundësi të licencohej nga MINT për arsye se kusht për licencim ishte kohëzgjatja e kontratës për 6 vite. Shkaku i i ndryshimit të Ligjit Nr.08/L-18 Për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtërishme, qiramarrësi kishte parashtruar kërkesë që kjo kontratë të zgjatet për 6 vite si dhe lirim nga pagesa e qirave për periudhën 15.03.2022 me 28.02.2023.

Bordi konsideron se nuk ka arsye për lirim nga pagesa e qirave për periudhën 15.03.2022 me 28.02.2023 duke qenë se qiramarrësi në tenderin për asetin në fjalë ka qenë i informuar për gjendjen e asetit, bazën ligjore në atë kohë, ndërsa me vetë dëshirë dhe vullnetin e tij ka pranuar ofertën prej 11,111.00€ përkatësisht kushtet e kontratës së qirasë të cilën e ka nënshkruar.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 qershor 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/5

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neni 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenit 10, paragrafi 1.2 i Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; Neni 2 i Rregullores 02/2023 për Plotësim/Ndryshimit të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore aprovuar me 17 maj 2023, si dhe nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të hapësirave afariste në katin e katërt të ndërtesës administrative nr. 2 (e njohur më parë si ish Bankos), me sipërfaqe totale prej 188.1 m2 në pronësi të NSh "Jugobanka" MIT101, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 300.00 për një muaj (bruto) për kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë.**

II. **Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Autoritetit të Likuidimit, se lidhja e Kontratës së Qirasë me KGJK për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh "Jugobanka" MIT101.

Bordi përmes vendimit Nr. Ref. BD-180/5 të datës 17 maj 2023 kishte aprovuar për qiradhënie tre (3)kate të ndërtesës së njëjtë pra katet 1,2, dhe 3. Tani KGJK ka kërkuar hapësirë shtesë, respektivisht katin 4.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Këshilli Gjyqësor i Kosovës për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë konform ndryshimeve të Rregullores Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik.

Në lidhje me këtë dhe në bazë të limiteve buxhetore të Sekretariatit të KGJK-së kanë deklaruar se për këtë hapësirë shtesë mund të paguajnë 300.00 €/muaj – shumë kjo e njëjtë me qiramarrës të tjerë në këtë ndërtesë.

Shfrytëzimi i këtyre hapësirave është i rëndësisë së veçantë dhe në interesin publik, për arsye se këto hapësira do të shfrytëzohen nga ana e punonjësve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Qiradhënia e asetit në fjalë do të shërbente edhe për mirëmbajtjen e asetit dhe do të zvogëlonte shpenzimet e fondeve të AKP-së për mirëmbajtjen e tij. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-183/6

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Lavërtari - Blegtori (në likuidim) PRN004, nga Rajoni i Prishtinës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Lavërtari - Blegtori PRN004.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh Lavërtari - Blegtori (në likuidim) PRN004, nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-183/7

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësues të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN023 NSh Fapol (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e plotësuesë të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN023 NSh Fapol (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Arsye që është kërkuar dhe aprovuar raporti plotësues është se në raportin e shpërndarjes së përkohshme të pjesshme të paraqitur më datë 22 shkurt 2022 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr.Ref. BD-159/17, nuk ishin të përfshirë tre kreditorët që janë të përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye ishin në listën e ankesave në raportin e shpërndarjes së përkohshme të shkurtit 2022, ndërsa në ndërkohe DHPGJS ka vendosur mbi ankesat e tyre dhe palën disa herë kanë parashtruar kërkesë që të ekzekutohen vendimet e Autoritetit të Likuidimit, përkatësisht Akgjykimet e Kolegjit të Apelit të DhPGJ-së. Kreditori me numër rendor tre në shtojcën 3 të këtij Raporti kishte parashtruar ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit edhe pse e kishte kërkesën e pranuar në total por me ankesë e kishte rritur shumën e kërkuar, ndërsa DHPGJS me aktgjykimin AC-I-21-0193 ka refuzuar ankesën e palës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së pare dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Njëjtë qëndron situata edhe me kreditorin me numër rendor katër në shtojcën 3 të këtij raporti, ku DHPGJS me aktgjykimin AC-I-21-0106 ka refuzuar ankesën e palës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tek kreditori me numër rendor pesë dhe gjashtë, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së me aktgjykimin AC-I-22-0007 ka aprovuar ankesën e palës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë C-IV-15-1079 dhe e ka obliguar Autoritetin e Likuidimit të ja paguajë shumën e paraqitur në shtojcën 3 të këtij raporti.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh Fapol (në likuidim) PRN023, nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-183/8

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN028 NSh 19 Qershori IMN (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e PRN028 NSh 19 Qershori IMN (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Arsye që është kërkuar dhe aprovuar raporti plotësues është se:

1. Në raportin e shpërndarjes së përkohshme të pjesshme të paraqitur më datë 19 korrik 2022 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr.Ref. BD-167/47, nuk ishin të përfshirë tre kreditorët që janë të përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, pasi që të njëjtët nuk kishin paraqitur kërkesa në likuidim brenda afatit për parashtrim të kërkesave dhe Autoriteti i Likuidimit vetëm i kishte njoftuar përmes shkresave që kërkesa e tyre nuk mund të shqyrtohet pasi që janë jashtë afatit dhe të njëjtit kishin parashtruar ankesë në DHPGJS. Për kreditorin me numër rendor tre dhe katër në shtojcën 3 të këtij raporti Kolegji i DHPGJS ka nxjerrur aktgjykimin AC-I-17-0229 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e palës dhe ka obliguar Autoritetin e Likuidimit të i paguajë shumat e paraqitura në shtojcën 3. Për kreditorin me numër rendor pesë dhe gjashtë në shtojcën 3 të këtij raporti Kolegji i DHPGJS ka nxjerrur aktgjykimin AC-I-17-0225 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e palës dhe ka obliguar Autoritetin e Likuidimit të i paguajë shumat e paraqitura në shtojcën 3. Për kreditorin me numër rendor shtatë dhe tetë në shtojcën 3 të këtij raporti Kolegji i DHPGJS ka nxjerrur aktgjykimin AC-I-17-0238 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e palës dhe ka obliguar Autoritetin e Likuidimit të i paguajë shumat e paraqitura në shtojcën 3.
2. Raporti i shpërndarjes së përkohshme për NSh "19 Qershori IMN" PRN028 është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve më datë 04.07.2022 me vendimin Nr. Ref. BD-166/57, mirëpo në raportin e paraqitur kishte ndodhur një lëshim teknik sepse në shumën totale të aprovuar ishte shuma gabim për arsye se tek njëri prej kreditorëve në listë, saktësisht tek kreditori me numër 43 në raportin e kaluar të shpërndarjes ishte bërë një lëshim teknik dhe ishte shumëfishuar shuma për këtë kreditor. Si pasojë, edhe raporti i shpërndarjes ishte paraqitur si i pjesshëm dhe pas rregullimeve të bëra ky Raport Korrigjues paraqitet si Raport i Shpërndarjes së Përkohshme. Raporti Korrigjues i Shpërndarjes së Përkohshme për NSh "19 Qershor IMN" ishte aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-167/47 më datë 28 korrik 2022.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme plotesuese të fondeve të Likuidimit të NSh PRN028 NSh 19 Qershori IMN, nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/9

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti Plotësues/Shtesë i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit të GJI042 NSh PMN Sharr (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.**
II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e plotësuese/shtesw të përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e GJI042 NSh PMN Sharr (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Arsye që është kërkuar dhe aprovuar raporti plotësues është se në raportin e shpërndarjes së përkohshme të pjesshme të paraqitur më datë 22 qershor 2022 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr.Ref. BD-166/58, nuk ishin të përfshirë pesë kreditorët që janë të përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye të ndryshme secili prej tyre. Kreditori me numër rendor tre në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes nuk ka qenë i përfshirë pasi që nuk ka qenë kërkesa e tij e regjistruar dhe e kategorizuar si e pranuar në databazë, kreditori me numër rendor gjashtë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes ka qenë në listën e ankesave në raportin e shpërndarjes të qershorit 2022, mirëpo ka deklaruar përmes të autorizuar që nuk ka ankesë në DHPGJS dhe kërkon që të i paguhet pjesa e aporvuar e vendimit të AL-së. Kreditorët me numrat rendor katër dhe pesë në Raportin e Shpërndarjes së gushtit 2018 janë paguar vetëm për kategorinë 40.1.6 dhe ju ka mbetur e pandarë paga për kategorinë 40.1.7 dhe tanimë janë ndarë dhe paraqiten për pagesë në këtë raport dhe për kreditorin me numër rendor shtatë është nxjerrë aktgjykimi nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së AC-I-20-0443 përmes së cilit ka refuzuar ankesën e palës dhe ka konfirmuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme plotwsuese/shtesw të fondeve të Likuidimit të GJI042 NSh PMN Sharr (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/10

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 Maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa me numër KB-1717/23; Nr.1080 e palës e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17.05.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: "Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë me ftohje ajrore" Ferizaj.**

II. **Autorizohet Drejtori Menaxhues që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05 2023 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: "Fabrika e këmbyesve të nxehtësisë me ftohje ajrore" Ferizaj. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/11

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 Maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa me numër KB-1671/22; Nr.4241 e palës parashtruese të kërkesës dhe – fëmijët e – bartëse e të drejtës banesore (e ndjerë) - e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17.05.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NN "Kabllar" Prishtinë.**

II. **Autorizohet Drejtori Menaxhues që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05 2023 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës parashtruese të kërkesës dhe – fëmijët e – bartëse e të drejtës banesore (e ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NN "Kabllar" Prishtinë. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO – Agjencia Kosovare e Privatizimit – Kosovska agencija za privatizaciju – Privatisation Agency of Kosovo – 20 / HQ / 08 – Prishtinë – Priština

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/12

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 Maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa me numër KB-1671/22; Nr.4241 e palës - e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17.05.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga HTP "Sloga" Prishtinë.**

II. **Autorizohet Drejtori Menaxhues që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05 2023 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës - për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga HTP "Sloga" Prishtinë. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/13

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 Maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa me numër KB-1708/23 e palës - e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17.05.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH KBI "Ereniku" (Prodhimtaria Primare) në Gjakovë.**

II. **Autorizohet Drejtori Menaxhues që të nënshkruajë kontratën e shitblerjes.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05 2023 me anë të cilit aprovohet si e bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH KBI "Ereniku" (Prodhimtaria Primare) në Gjakovë. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023.

REPUBLIKA E KOSOVËS - Agjencia Kosovare e Privatizimit - 20 / NO / GS - Prishtinë - REPUBLIC OF KOSOVO - Privatisation Agency of Kosovo

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
ëëë.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/14

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet kërkesa me numër KB-1476/17e parashtruar nga pala , e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17 Maj 2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Stacioni i veterinës Dragash - OP '' Sharr - Prodhimi'' në Dragash.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05.2023 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim Stacioni i veterinës Dragash - OP '' Sharr - Prodhimi'' në Dragash

Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të argumentoj me anë të provave se është bartës i të drejtës banesore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk mund të kualifikohet si bartës i së drejtës banesore me arsyetimin se pala nuk posedon Kontrate mbi shfrytëzimin e banesës të lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore (ish BVI). Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6 , lidhur me nenin 37 dhe 38 te ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-183/15

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 17 maj 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L -247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi te cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 Qershor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet kërkesa me numër KB-1695/23 e parashtruar nga pala e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 17 Maj 2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH NIN " Ramiz Sadiku" në Prizren**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 17.05.2023 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim NSH NIN " Ramiz Sadiku" në Prizren.

Parashtruesi i kërkesës , nuk ka arritur të argumentoj me anë të provave se është bartës i të drejtës banesore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk mund të kualifikohet si bartës i së drejtës banesore me arsyetimin se vendimet të cilat janë nxjerr pas vitit 1999, bien ndesh me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dispozite kjo e cila kishte suspenduar nenin 3 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr.11/83-29/86 dhe 42/86).

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 Qershor 2023

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO - Agjencia Kosovare e Privatizimit - Kosovska agencija za privatizaciju - Privatisation Agency of Kosovo - Prishtinë - Priština

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
